

**VENDIM**  
**Nr. 589, datë 22.7.2020**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR NJË NDRYSHIM NË KONTRATËN E QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 642, DATË 2.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e miratimit për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, miratuar me vendimin nr. 642, datë 2.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “MTSC” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore “Ish-ndërmarrje metalike “Tirana” (Reparti i orëve), prona nr. 19, me numër pasurie 7/649, zona kadastrale 8220, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë”, të ndryshuar, sipas projektkontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË**

Nr. \_\_\_\_\_ rep.

Nr. \_\_\_\_\_ kol.

**PROJEKTKONTRATË**

**ANEKSKONTRATË QIRAJE**

**lidhur**

Në Tiranë, sot, më datë \_\_\_\_\_, të muajit \_\_\_\_\_, të vitit 2020 (dymijë e njëzet), u paraqitën para meje, noterit \_\_\_\_\_, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, përfaqësuar me autorizim të ministrit, nr. \_\_\_\_\_ nga z. \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_, në këtë Ministri, i datëlindjes \_\_\_\_\_, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare i pajisur me letërnjoftimin me numër personal \_\_\_\_\_, që më poshtë do të quhet **“Qiradhënës”**

dhe

**Shoqëria “MTSC” sh.p.k.**, me seli në Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), me numër identifikimi L51817008H, përfaqësuar nga administratorja e shoqërisë, znj. Vilma Theodhos, e identifikuar me kartën e identitetit me numër personal G75829026B, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet **“Qiramarrësi”**:

Të cilët deklaruan se:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, të ndryshuar, **kërkesën subjektit qiramarrës**, për një ndryshim në kontratën e qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, miratuar me vendimin nr. 642, datë 2.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “MTSC” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore “ish-Ndërmarrja Metalike “Tirana” (Reparti i Orëve), prona nr. 19, me numër pasurie 7/649, zona kadastrale 8220, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë”, të ndryshuar, bazuar në nenet 801–825, të Kodit Civil, së bashku me “Qiramarrësin”, palët bien dakord të hartojnë këtë anekskontratë, me ndryshimet si vijon:

Neni 1

Në nenin 2 “Qëllimi i përdorimit” dhe në fjalinë e parë të pikës 5.7, të nenit 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit”, fjalët “...rikonstruksionin total...”, zëvendësohen me “...rikonstruksionin minimalisht të totalit...”.

Neni 2

Anekskontrata është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë nr. 2604 rep., nr. 727 kol., datë 14.10.2019 dhe shtesës së kontratës nr. 479 rep. dhe 189 kol., datë 28.2.2020 dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët.

Anekskontrata është formuluar në gjashtë kopje origjinale dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe pranuan, e nënshkruan atë para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë dhe unë noter \_\_\_\_\_, në bazë të nenit 801 e në vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë rregullisht.

**QIRADHËNËSI**

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë,  
Përfaqësuar nga:**

**QIRAMARRËSI**

**Shoqëria “MTSC” sh.p.k.  
Përfaqësuar nga:**